



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 19 QERSHOR 2019 - VAZHDIM**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 19. JUNA 2019. GODINE - NASTAVAK**

**QERSHOR - JUN  
2019**

## **Rendi i ditës**

### **Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme**

I. Shqyrtimi i Propozim-Amendamentit nr. 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i propozuar nga 80 deputetë të Kuvendit.

### **II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7 mars 2019**

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
3. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017,
4. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
5. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,
6. Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,
7. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,
8. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor,
9. Votimi për shkarkimin e një (1) anëtari të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare,
10. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës,
11. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,
12. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave,
13. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike,
15. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP-Partia Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh. a./NKEC.

### **III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 30 janar 2019**

1. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore,

2. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,
3. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
4. Votimi në parim i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

#### **IV. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 28 shkurt 2019**

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
3. Votimi në lexim të dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
5. Votimi i rëndit të dytë për zgjedhjen e gjashtë (6) anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

#### **V. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 12 mars 2019**

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara.

#### **VI. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 13 mars 2019**

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti.

#### **VII. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2019**

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për situatën e krijuar në arsim pas vendimit të SBASHK-ut për të refuzuar kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës 3-javore.

#### **VIII. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 11 prill 2019**

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me zbrazjen e vendit nga të rinjtë, si rreziku më i madh që i kanoset vendit që nga paslufta.

#### **IX. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 prill 2019**

1. Shqyrtimi i Propozim-programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019,
2. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributdhënës,
3. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, në lidhje me mosekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,

4. Votimi i raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës,
5. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-“KOSTT” sh. a.,
6. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për kompensimin e anëtarëve të këtij komisioni,
7. Propozimi i GP të Listës serbe për emërimin e zëvendëskryetarit të dytë në Komisionin ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social dhe propozimet e grupeve parlamentare të PSD-së dhe LVV-së për zëvendësimin e deputetëve në komisione parlamentare.

## **Dnevni red**

### **Nedovršene tačke sa prethodnih sednica:**

I. Razmatranje Predlog amandmana br. 26. Ustava Republike Kosovo, predložen od 80. Poslanika Skupštine.

### **II. Nedovršene tačke sa plenarne sednicu održane 7 mart 2019. god.**

1. Drugo glasanje Nacrt zakona o porezu na lične dohotke,
2. Drugo glasanje Nacrt zakona o porezu na prihode korporacija,
3. Glasanje Godišnjeg izveštaja Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2017.godinu.,
3. Glasanje Izveštaja Komisije za budžet i finansije u vezi nadgledanja primene Zakona o bankama, mikro-finansijskim institucijama i nebankarskim finansijskim institucijama,
4. Glasanje Izveštaja Komisije za ljudska prava, polnu ravnopravnost, nestala lica i peticije u vezi nadgledanja primene Zakona o zaštiti od diskriminacije,
5. Glasanje Izveštaja revizije godišnjih finansijskih pregleda Ministarstva kulture, omladine i sporta za 2017. godinu,
6. Glasanje Izveštaja o stanju životne sredine na Kosovu za 2017. godine,
7. Glasanje za Imenovanje 7 (sedam) članova u Kosovskom savetu za kulturno nasleđe,
8. Glasanje za Razrešenje jednog (1) člana Borda Regulatornog autoriteta elektronskih i poštanskih komuniciranja,
9. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi neuspeha i skandala spoljne politike Republike Kosovo,
10. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi angažovanja Predsednika Kosova u uključivanju “razmene teritorija” ili “korigovanja granica” u dijalogu između Kosova i Srbije,
11. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa neuspesima vladajuće koalicije koji su kulminirali zbog ne liberalizacije viza,
12. Glasanje o preporukama od parlamentarne debate o slučaju seksualnog uznemiravanja i silovanja, nezakonitog abortusa maloletnice i institucionalnoj odgovornosti Vlade Kosova,
13. Prvo razmatranje N/zakona o jakim alkoholnim pićima,
14. Glasanje preporukama sa Interpelacija ministra za ekonomski razvoj g. Valdrin Lluka, na zahtev predsednika PG- PSD g. Dardan Sejdiu, uz podršku 11 poslanika, u vezi osnivanja Novog energetskog preduzeća Kosova A.D./NKEC.

### **III. Nedovršene tačke sa plenarne sednice održane 30. januara 2019. god.**

1. Glasanje N/zakona o ratifikaciji za Dodatni Protokol 5 uz Sporazum o izmeni i pristupanju Centralno Evropskom Sporazumu o slobodnoj trgovini,
2. Glasanje u načelu Nacrta zakona za izmene i dopune zakona br.02/L-88 o kulturno nasleđe,
3. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.03/L-064 o službenim praznicima u Republici Kosovo,
4. Glasanje u načelu N/zakona o visokom obrazovanju Republike Kosova.

#### **IV. Nedovršene tačke sa plenarne sednice održane 28. februara 2019. god.**

1. Drugo glasanje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.05/L-132 o vozilima,
2. Drugo glasanje Nacrta zakona o rudnicima i mineralima,
3. Drugo glasanje Nacrta - poslovnika Skupštine Republike Kosova,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
5. Glasanje u drugoj rundi za izbor šest (6) članova Saveta za besplatnu pravnu pomoć.

#### **V. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 12. marta 2019. god.**

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata o odluci Vlade Republike Kosovo za izdvajanje finansijskih sredstava iz nepredviđenih troškova.

#### **VI. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 13. marta 2019. god.**

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa blokiranjem Centralne izborne komisije od strane Predsednika.

#### **VII. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 28. marta 2019. god.**

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata o nastaloj situaciji u obrazovanju, nakon odluke USONK-a za odbijanje naknade izgubljenih časova, tokom 3 nedelje.

#### **VIII. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 11. aprila 2019. god.**

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi napuštanja zemlje od omladine, kao najveći rizik koji pretil zemlji od posleratnog perioda.

#### **IX. Nedovršene tačke sa plenarne sednice održane 12. aprila 2019. god.**

1. Razmatranje Predlog-programa rada Skupštine Republike Kosovo za 2019. godinu,
2. Glasanje Predlog-rezolucije od parlamentarne debata, na zahtev poslanice Teuta Haxhiu, podržan od 9. (devet) poslanika - potpisnika za održavanje parlamentarne rasprave o pravima penzionera platiša doprinosa,
3. Glasanje Predlog-rezolucije od parlamentarne debata, na zahtev poslanika Faton Topalli o neizvršenju Presude Ustavnog suda Republike Kosovo,
4. Glasanje Izveštaja Parlamentarne istražne komisije u vezi sa troškovima za lobiranje od strane Predsednika i Vlade Republike Kosova,
5. Izbor članova borda Javnog preduzeća operator sistema, transmisije i tržišta -“KOSTT” sh. a.,
6. Zahtev Parlamentarne Anketne Komisije vezano za troškove lobiranja od strane Predsedništva i Vlade Republike Kosova, za nadoknadu članova ove Komisije,
8. Predlog PG SL za imenovanje drugog zamenika predsednika Ad hoc komisije za izradu Zakonika o regulisanju i menadžiranju penzija i beneficija socijalnog osiguranja i predlog parlamentarne grupe PSD i LVV za zamenu poslanika u parlamentarnim komisijama.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në vazhdim të seancës,

Me aq sa po shoh, aktualisht janë 55 deputetë.

Në rrethana të tilla, mbasi jemi afër, presim edhe 15 minuta pauzë, vazhdojmë në momentin që bëhen 61 deputetë.

\* \* \*

Jemi në vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

61 deputetë janë në sallë aktualisht, mund të bëhen më shumë.

U dëshirojmë mirëseardhje disa nxënësve dhe mësueseve të tyre, i falënderojmë që i kemi sot mysafirë në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mirë se keni ardhur, të dashur fëmijë. Faleminderit!

### **1. Shqyrtimi i Propozim-amendamentit numër 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i propozuar nga 12 deputetë të Kuvendit**

63 deputetë jemi në sallë, kjo duhet të ketë dy të tretat e deputetëve, derisa nuk plotësohen kushtet ligjore, nuk do ta vej në votim.

Shkojmë në pikat e papërfunduara nga seanca plenare mbajtur më 7 mars 2019.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për pikat e rendit nga 1 deri 13 dhe 15 kanë përfunduar, në fakt, pikat e rendit të ditës në seancat plenare të mëparshme.

### **1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale**

Në seancën plenare të mbajtur më 30 maj 2019 Kuvendi ka miratuar 25 amendamente të propozuara nga Komisioni Funkcional, po nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje për miratimin e amendamenteve 7 dhe 16 të propozuara nga deputetët.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit 7.

Zonja Shqipe Pantina e ka një propozim, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zonja deputete dëshiron të votohet, e nxjerr menjëherë në votim.

A shkojmë në mënyrë elektronike, apo dëshironi në mënyrë formale.

Votojmë në mënyrë elektronike, amendamenti 7, propozim i deputetes Shqipe Pantina, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Regjia, kur të bëhemi gati, shkojmë në votim, votojmë tash!

Ky është votimi, 40 deputetë. 63, përkatësisht 64 mund të jenë aktualisht në sallë.

Unë do ta vej edhe një herë më vonë gjatë kësaj seance. Po nuk po kalojmë më tutje në amendamentet e tjera, për vetë faktin se në momenti ku një amendament nuk kalon, është e pamundshme, në bazë të Rregullores, të aprovohet ndonjë ligj.

## **2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave**

Në seancën e mbajtur më 30 maj 2019, Kuvendi ka miratuar 24 amendamente të propozuara nga Komisioni Funkcional, po nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje për miratimin e amendamentit 5.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit 5, propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, zoti deputet, fjala për ju.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dola edhe një herë të sqaroj amendamentin e propozuar dhe të kërkoj mbështetjen tuaj për një çështje, e cila është në interesin e përgjithshëm, është në interesin publik, për harmonizimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe Ligjin për sponsorizime.

Definitivisht ky amendament do të mundësojë implementimin e Ligjit për sponsorizime, një interes për zhvillimin e kulturës, rinisë dhe sportit.

Prandaj, pa dallime politike, kërkoj mbështetjen tuaj, sepse do t'i japë një mundësi edhe më të mirë zhvillimit të sportit, kur këto ditë ne i kemi shijuar fitoret e kombëtares sonë, është mundësia që ne të mbështesim sportin tonë përmes këtij ligji, por edhe kulturën, duke filluar prej deputetit më të vjetër këtu, bacit Adem, i cili vërtet ka dhënë kontributin e tij në fushën e kulturës, por do të japë mundësi që kultura përmes këtij ligji të zhvillohet edhe më shumë, po ashtu edhe sportit.

Prandaj, duke ditur që sportistët nuk janë përcaktuar në parti politike, por po na bëjnë krenarë të gjithëve, edhe ne duhet të bëjmë një gjë të tillë për ata. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Zoti deputet, t'u përmend emri, po e shoh, e ke kërkuar fjalën. Zoti Adem Mikullovcit e ka fjalën.



ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Vetëm të plotësoj disa fjali, duke thënë që sporti është një aktivitet gjithëpopullor, gjithërinor i një kombi.

Sporti ka harxhimet e veta dhe është një veprimtari bukur e shtrenjtë. Unë vetëm kisha pasur dëshirë që ky sponsorizim të jetë me një përqindje sa më të madhe për sport, e jo për kulturë. Se kultura ka nevojë shuma të vogla dhe më të pakta.

Mirëpo, do të kërkoj, se për sa e kam lexuar ligjin, nuk është i domosdoshëm, është pak si vullnetar ky sponsorizim, a jep 20% a 10%, kisha pasur dëshirë të përcaktohej një nivel, 20%, për shembull, të tatimit të domosdoshëm për secilën veprimtari, për secilin tatim, e të formohen zyra, të formohen, nuk po di qysh të them, trupi punues, i cili i menaxhon këto mjete dhe bën shpërndarjen e tyre.

Sporti i Kosovës mund të mbahet vetëm në këtë mënyrë, se shteti si shtet nuk ka mundësi në asnjë mënyrë ta përforcojë, stadiumet a palestrat, është angazhim gjithërinor i krejt popullit të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Jemi te amendamenti 5.

Deputeti Bekim Haxhiu e ka propozuar amendamentin 5, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL për përkrahjen e sportistëve, votojmë tash!

69 deputetë janë në sallë.

50 kanë votuar, prezenca fizike është, e vendosim edhe një herë, në qoftë se doni.

Amendamentin 5, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, votojmë tash!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit!

Kanë votuar 46 deputetë, nuk ka arritur votat e domosdoshme.

Zoti Sherifi, e ke fjalën.

BILALL SHERIFI: Zoti kryesues,

Ne kemi parë disa herë që ky amendament është pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe nuk po kalon. Ne po e dimë, besoj, siç na kanë kërkuar neve si grup parlamentar komuniteti i sportistëve që ta mbështesim këtë amendament, kanë kërkuar edhe nga grupet e tjera.

Do të kisha pasur dëshirë të dëgjoj arsyet, argumentet e Komisionit FunkSIONAL pse ka qenë kundër një amendamenti të tillë, sepse vërtet më del të jetë nonsens mosmbështetja e këtij amendamenti, i cili i hap rrugë mbështetjes së sportit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të gjithë e kanë të drejtën e fjalës, për secilin amendament veç e veç. Nuk po paraqitet askush, Bilall.

### **3. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017**

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti.

Votojmë raportin, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Faleminderit! Edhe për këtë pikë të rendit të ditës rezultati është i njëjtë, 47 vetë kanë votuar, e lëmë, e votojmë edhe javën e ardhshme prapë.

Zoti Bekim Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë, edhe një herë,

Amendamentin të cilin e kam propozuar, po dua të kthehem te pika në të cilin ishim, amendamenti të cilin e kam propozuar nuk është duke kaluar për shkak të mospërkrahjes së Komisionit FunkSIONAL, po më shumë për shkak, ndoshta, të qëndrimeve politike të grupeve politike.

Unë po kërkoj edhe një herë që të kthehet në rivotim ky amendament, sepse edhe grupet politike tani e kanë të gjithë të qartë, sepse pa dallim orientimeve tona politike, mbështetja e këtij amendamenti, harmonizimi i këtij amendamenti me Ligjin për sponsorizimin, me Ligjin për të ardhurat e korporatave, do t'i japë mundësi zhvillimit të sportit dhe neve vërtet sportistët do të vazhdojnë të na bëjnë krenarë në arena sportive dhe ne duhet të bëjmë këtë.

Pra, edhe mes konsultimeve që pata ndërkohë me përfaqësuesit e grupeve politike, është një kërkesë që të kthehet edhe një herë në rivotim dhe pastaj të gjitha grupet politike ta votojmë këtë amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mikullovc i ka kërkuar fjalën prapë. Zoti Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Vetëm desha ta përkrah Bekimin, njerëz, kuptoni, deputetë të nderuar, ky amendament duhet të votohet, është në pyetje gjithë rinia, komplet rinia shqiptare e Kosovës. Është një nga amendamentet, i cili patjetër duhet të votohet.

KRYESUESI: Unë mendoj që e vërteta historike e mbështetjes së sportit dhe kulturës ka qenë e obliguar në mënyrë ligjore, përmes taksave ose tatimeve që kanë paguar punëtorët e krejt administratës së Kosovës. Më kujtohet, për shembull, punëtorët e Obiliqit që kanë paguar më shumë për kulturën, për ato kanë pasur pa para të hyjnë në teatër, në manifestime të ndryshme dhe në stadione, e ku ta di unë.

Edhe ne diçka të tillë duhet të bëjmë, me qëllim që, vërtet, nëse nuk kemi mundësi t'i financojmë shëndetësinë e të tjera, ashtu siç duhet, të paktën kulturën dhe sportin duhet ta financojmë me një bazë materiale të garantuar nga shteti.

Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Sa për sqarim, me projektligjin e propozuar nga Qeveria është paraparë mundësia e zbritjes nga tatimi në të ardhurat personale dhe korporatat për persona që kontribuojnë në formë të donacioneve dhe sponsorimeve për qëllime humanitare, shëndetësore, rekreative, arsimore, fetare, shkencore e kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive deri në 10%, si dhe një zbritje shtesë prej 10% që parashihet me ligj të veçantë për këto qëllime.

Komisioni, në këtë rast Grupi Punues, në të cilin unë jam i autorizuar, kemi bërë një ndryshim, domethënë përmes amendamentit 17, ka propozuar që zbritja shtesë për qëllime të sponsorimit të jetë 20% dhe në total zbritja e lejuar për sponsorime të donacioneve lejohet deri në 30%.

Në këto sponsorizime që ka bërë komisioni, ka bërë të mundur që të njihen shpenzimet deri në 30%, siç është kërkuar edhe në amendamentin e deputetit Bekim Haxhiu.

Mirëpo, për shkak se ligjet tatimore janë ligje speciale për tatime, ku janë të përcaktuara kriteret dhe kushtet në bazë të të cilave lejohet dhe pranohen zbritja për tatime në të ardhura për shpenzime dhe kontribute të caktuara. Ndërsa Ligji për sponsorim nuk i parasheh kriteret për zbritjen e sponsorimeve. Mendoj që isha i qartë, për shkak se ligjet e Administratës Tatimore që kanë të bëjnë me tatimet janë ligje speciale dhe Ligji për sponsorime nuk është ligj special, prandaj është dashur të bëhet harmonizimi i këtyre dy ligjeve dhe zgjidhjen e kemi bërë. Unë ia kam shpjeguar Bekimit edhe në mënyrë praktike qysh ndodh kjo, domethënë e kam edhe në formë tabelare dhe për këtë jemi pajtuar.

Vetëm është rregulluar që çdo gjë të shkojë nëpërmjet Administratës Tatimore. Ndërsa qëllimi është i njëjtë. Në këtë rast, për sport nga tatimi në të ardhura personale në fitim mund të ndahen deri në 30% që i lejon ligji, domethënë 20 plus 10.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kjo është një çështje, për të cilën është diskutuar disa herë edhe viteve të kaluara në Kuvend, në fakt është një çështje, e cila prej vitit 2009 është tentuar të rregullohet me një ligj të veçantë, me Ligjin për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Dhe, përfundimisht ky ligj është miratuar para pak vjetësh, por arsyeja pse ne e kemi sot ose, në fakt, që disa javë në seancë ka të bëjë me faktin që përkundër miratimit të ligjit, ai nuk është respektuar asnjëherë nga Administrata Tatimore e Kosovës, duke e pamundësuar zbatimin e një ligji me arsyetimin që ata janë të obliguar t'i zbatojnë veç ligjet bazike apo ligjet, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me çështjen e tatimeve. Gjë që, për mendimin tim personal, nuk është ndonjë arsyetim, sepse Kuvendi kur e miraton një ligj, janë të obliguara të gjitha institucionet ta respektojnë. Ka qenë qëllimi, besoj, i përbashkët të rregullohet përmes këtij ligji që e kemi në seancë edhe sot dhe ajo që zoti Osmani e tha, realisht është e vërtetë, por e ka një dallim fundamental. Mënyra e kalkulimit është krejtësisht tjetër në Ligjin për sponsorizime dhe krejtësisht tjetër në propozimin e Qeverisë dhe të Grupit punues. Nuk është aspak joshëse propozimi të cilin e ka grupi punues, sepse tash, s'dua të bëj matematikë edhe t'ju lodhi me çështje teknike juve ose shikuesit, por ideja që të lejohen deri në 10 apo +20, apo ta zëmë deri në 30% të konsiderohen si shpenzime para tatimit, është krejt tjetër prej idesë që 30% të shumës që e kanë obligim të paguajnë tatim kompanitë në Kosovë, të kenë mundësi ta japin si sponsorizim.

Ky opsion është insentivë, unë nuk po them që është opsioni më i mirë në botë, ose që është opsioni ideal, por është një zgjidhje optimale. Për këtë çështje ka pasur dhe do të ketë edhe në të ardhmen mendime të ndryshme, por opsioni i Grupit punues, të cilin e ka mbështetur edhe qeveria, nuk është aspak joshës, nuk është insentivë për kompanitë dhe në këtë formë nuk ka shans të binden kompanitë të investojnë në sport, në sportistë, në kulturë, në art e kështu me radhë. Kërkesa ose ftesa jonë është që të votohet amendamenti, i cili është propozuar nga deputeti Haxhiu dhe që s'e ka mbështetjen e komisionit, jo për ta rrëzuar vendimin e komisionit, por pse besojmë që është zgjidhja më e mirë dhe ndoshta, përfundimisht Administrata Tatimore fillon t'i respektojë ligjet e Republikës së Kosovës, sepse në rastin e Ligjit për sponsorizime nuk e ka respektuar. Tek e fundit, e kemi obligim ta provojmë, sepse nëse ka një fushë që neve këtu pa dallime, dhe jo vetëm këtu, na bën të ndihemi mirë, është pikërisht sporti dhe rezultatet e sportistëve tanë. T'i japim shans këtij opsioni, nëse me të vërtetë shihet që nuk po funksionon, që ka vështirësi, atëherë mund të rikthehemi dhe të gjejmë një model apo një zgjidhje tjetër. Ka edhe modele të tjera, të cilat ne s'i kemi shqyrtuar asnjëherë, por sot për sot t'i japim mundësi

opcionit, të cilin e kemi para vetes, në mënyrë që, tek e fundit, ta testojmë për një periudhë kohore se si do të funksionojë.

Unë jam i bindur që do të funksionojë pozitivisht dhe jam absolutisht i bindur që ky opsion është insentivë e vërtetë për kompanitë dhe për individët shumë më shumë se sa opsioni i propozuar prej Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues! Duhet ta dimë që është nevojë e domosdoshme sponsorizimi i të gjitha kategorive që u përmendën, e në veçanti të kategorive që po korrin suksese dhe po i japin fuqi shtetit të Kosovës. Nëse kemi të bëjmë me disa kufizime speciale, duhet të flasim, pra edhe për suksese speciale të sportistëve tanë, të cilët kanë thyer barriera në ato vende ku edhe shteti s'ka mundur të kryejë punë, prandaj konsideroj që Administrata Tatimore duhet të kryejë obligimet ligjore që i dalin nga ligjet në fuqi dhe ne si grup parlamentar jemi në përkrahje të amendamentit, sepse konsiderojmë që meritojnë kategoritë e caktuara, por sidomos sportistët, të cilët Kosovën e kanë bërë me emër dhe kanë treguar që ka shtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti! Në fakt, e mora fjalën vetëm për të përsëritur ndoshta atë që e thanë edhe një pjesë e kolegëve të mi deputetë, për nevojën që ne të përkrahim amendamentin e zotit Haxhiu, jo vetëm për t'i dhënë mbështetje këtij amendamenti, por për të përkrahur një numër të madh të komunitetit, i cili vjen nga sporti, kultura dhe që është bazament i fuqishëm i shtetit.

Në fakt, janë ambasadorët më të mirë të Republikës të Kosovës, me të cilët Kosova po krenohet në të gjitha vendet, prandaj konsideroj që këto barriera, të cilat më ne nuk po arrijmë që t'i thyejmë përmes Ligjit për sponsorizime, ku ata do të duhej të marrin përkrahje, t'i realizojnë përmes nenit 29, në fakt, amendamentit të zotit Haxhiu. Besoj shumë se të gjitha grupet parlamentare kanë pasur kontakt me sportistët, përfaqësues të kulturës, sportit dhe përfaqësues të tjerë, të cilët kanë kërkuar mbështetje nga të gjitha grupet parlamentare. Po konsideroj që Komisioni Funkcional do të duhej edhe një herë ta trajtojë me seriozitet këtë neglizhencë që është lëshuar, duke mos mundësuar që këto kategori të përfitojnë përmes këtij projektligji dhe të sjellë para deputetëve një zgjidhje, në mënyrë që kjo kategori që është trajtuar kaq gjatë, të arrijë të përfitojë nga sponsorizimet. Edhe një herë po e përsëris, janë prej kategorive më të rëndësishme të shtetit që duhet të kenë përkrahje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

**BILALL SHERIFI:** Kryesues, unë e mora fjalën vetëm sa për të falënderuar edhe anëtarin e komisionit për sqarimet që u dhanë dhe të tregoj ku e vëreja unë dallimin. Mendoj që në esencë të dyja qenkan njëjtë, por amendamenti i komisionit kërkon më shumë burokraci, vështirëson procesin e mbështetjes së sportit, kulturës, të artit nga kompanitë, të cilat do dëshironin të investonin. Ndërsa, amendamenti është me më pak burokraci dhe më shpejt realizohet qëllimi i mbështetjes, qëllimi i dhënies së donacioneve.

Prandaj, mendoj që do të ishte mirë që amendamenti të mbështetet në funksion të mbështetjes të këtij sektori të shoqërisë, që të gjithë e thamë dhe vazhdimisht po e themi që është shumë i rëndësishëm, në veçanti për rininë që do të mund të përfshiheshin shumë më shumë në aktivitete sportive e kulturore, se sa në aktivitete të tjera, siç sot bëjnë, për të mos mbajtur këtu ligjërata, sepse besoj të gjithë e dinë. Pra, le të krijojmë një mundësi që paraja të shkojë më shumë te këta sektorë për të mobilizuar rininë, për ta mbajtur aktivë në fushën e sportit, kulturës dhe të artit. Pra, dallimi në esencë nuk qenka i madh, të dy normativat, të dyja lejojnë subvencionimin apo dhënien e donacioneve, amendamenti e thjeshtëson procedurën e marrjes së tyre. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Bekim, e deshe prapë fjalën? Zoti Haxhiu!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Vetëm po dua t'i plotësoj parafolësit e mi, që Ligji për sponsorizime ka hyrë në fuqi më 19 janar 2017, por nuk ka gjetur zbatimin e tij për shkak të mungesës së harmonizimit me Ligjin për tatime në të ardhura dhe korporata. Sa u përket kriterëve se kush përfiton dhe si realizohet sponsorizimi, ministritë e linjës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Financave kanë nxjerrë udhëzime administrative për kriteret për sponsorizime për të parandaluar çdo mundësi të evazionit fiskal apo të manipulimit dhe se askush nuk do të mund të përfitojë as një 10 euro nga sponsorizimet nëse ato nuk bëhen përmes kriterëve dhe qarkullimit bankar financiar.

Pra, kriteret janë të përcaktuara, tani na duhet vetëm vota e deputetëve që kjo të zbatohet dhe vërtet t'i japim një mbështetje zhvillimit të sportit dhe ky harmonizim të jetë i mundshëm për zbatimin e ligjeve. Pra, edhe një herë po e kërkoj votën tuaj për këtë amendament, mbështetjen pa dallime politike, sepse sportistët janë të gjithëve dhe po na bëjnë krenarë të gjithëve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryesues! E para, po habitem pse ekziston qoftë edhe dilema minimale te çdo deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës për votimin e këtij amendamenti. Me votimin e këtij amendamenti, ne po ndihmojmë sportistët tonë që faktikisht vetëm muzikantët dhe sportistët janë ata, ajo pjesë e shoqërisë që po ia zbardh fytyrën Kosovës.

E dyta, në vend që ne sot të hapim debatin se si ka mundësi që Agjencia Tatimore e Kosovës i pranon si shpenzime nga Postë Telekom i Kosovës ose nga KEK-u, nga të gjitha ndërmarrjet publike i pranon donacionet si shpenzime, ndërkohë që e godet, e vret dhe e falimenton, e bankroton çdo kompani të biznesit privat, duke mos ia njohur të drejtën e shpenzimeve me rastin e donacioneve. Tani këto kompani private kanë qenë deri më sot të detyruara t'u japin ndihmë sportistëve tanë në të zezë, u kanë dhënë para në dorë, sepse nuk u është pranuar si shpenzim i kompanisë nga ana e ATK-së. Ne kemi miliona donacione nga Postë-Telekomi i Kosovës që janë dhënë krejt pa lidhje, qoftë edhe për frizura, qoftë edhe për videoklipe dhe, që ta dinë deputetët e Republikës së Kosovës, donacionet e Postë-Telekomit të Kosovës kalojnë shumën e buxhetit njëvjeçar që e ka pasur komplet Ministria e Shëndetësisë, imagjinojeni Postë-Telekomi i Kosovës ka dhënë donacione lidhje pa lidhje, më shumë se sa ka pasur buxhet komplet Ministria e Shëndetësisë.

Prandaj, ju lus, pavarësisht se kush e ka mik, që unë s'e kam fare Bekim Haxhiun mik, po të mos na kapë inati që e ka propozuar amendamentin Bekim Haxhiu dhe tash ne nuk po e votojmë këtë amendament. Ne si deputetë duhet të shqetësohemi se si ka mundësi që ne kemi kaq pak fusha të sportit, si ka mundësi që Kosova është i vetmi vend evropian që nuk ka salla të koncerteve dhe në vend që të gëzohemi që sektori privat, prej të cilit ne i marrim rrogat edhe si deputetë të Republikës së Kosovës, ne hajde t'ia lëshojmë ATK-në në shpinë, hajde t'ua lëshojmë ligjin në shpinë atyre privatëve, të cilët po duan ta ndihmojnë sportin në Kosovë. Prandaj, që ta përfundoj, zoti Haxhiu, edhe pse jemi kundërshtar politik, e ke mbështetjen absolute timen ti dhe të gjithë sportistëve, sepse bash fytyrën na e kanë zbardhur në Bullgari.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë, duke pasur parasysh deklaratimet e të gjithëve do të kërkoja që përfaqësuesi i Komisionit për Buxhet të japë sqarime shtesë rreth asaj pse ka qenë komisioni kundër. Unë për veten timen në qoftë se po kërkohet që këto donacionet të eskivojnë e të mos shkojnë përmes ATK-së, unë do të votoja kundër, sepse atëherë abuzimi do të jetë i shumëfishtë dhe i mundshëm, për t'u abuzuar në të gjitha fushat, pastaj të gjitha kompanitë, edhe për të shkuar deri aty që të bëhet edhe pastrimi i parasë, por edhe ikje nga obligimet që kanë kompanitë për tatim.

Mendoj që Lumiri do të duhej ta deklarojë këtë çështje. Po, merre fjalën, a pas 5 minutave. Ok! Mirë! Zoti Haxhiu e ka fjalën edhe një herë.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar zoti Haliti!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky ligj bën harmonizimin dhe asnjë rast nuk e ka qëllimin e devijimit nga Administrata Tatimore. Të gjitha tatimet, të cilat paguhen, tatimet në fitim, të cilat paguhen në Administratën Tatimore nga kompanitë, atëherë 30% nga kjo është zbritja që atyre Administrata Tatimore ua lejon për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Pra, po flasim për një sektor që e rregullon në

detale kush ka drejtë të përfitojë sponsorizimet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit sipas ligjit, i cili është miratuar më 19 janar 2017, dhe e cila është detyrë dhe përgjegjësi e respektimit dhe zbatimit të Administratës Tatimore dhe me këtë ligj ne kemi përcaktuar kriteret detale për të mos lejuar që dikush të abuzojë me donacionet apo sponsorizimet dhe kemi përcaktuar edhe kriteret e sakta që kjo të mos ndodh. Pra, që të parandalohet evazioni fiskal dhe që të mos numërohet shpenzim ajo që nuk është shpenzim. Por, në për të qenë më lehtë e zbatueshme çdo kompani e cila paguan tatim në fitim në Administratën Tatimore 30% e kësaj i lejohej zbritje në fushën e sportit dhe 20% në fushën e kulturës. Kjo është esenca e këtij ligji dhe harmonizimi dhe zbatimi i tij.

Pra, po kërkoj nga kolegët deputetë të të gjitha grupacioneve politike, ashtu siç kanë dalë me e kërkuar votën e tyre tek sportistët në fushatat elektorale, le t'i mbështesin sot me votën e tyre të gjitha grupacionet politik. Më vjen mirë, që shumica e grupeve politike u përcaktuan dhe orientuan votën e tyre pro. Pra, po kërkojmë vetëm edhe dy grupe politike kanë mbetur pa u përcaktuar për këtë votë. Është LDK-ja dhe Vetëvendosja, prandaj po kërkoj edhe le ta respektojnë edhe në vetë Vetëvendosje deklarimin e deputetit Adem Mikullovc i cili është vërtet një aktivist dhe një artist i madh i fushës së kulturës, por edhe të gjithë të tjerëve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën.

**KUJTIM SHALA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!  
Të nderuar kolegë. problemi është shumë i thjeshtë.

Fajin s'e ka Administrata Tatimore. Ne patëm miratuar Ligjin për sponsorizim në vitin 2017 dhe më kujtohet, meqë unë isha ministër dhe përfaqësoja Qeverinë në këtë rast ju kam kërkuar në dy-tre raste që të mos e votoni amendamentin e Komisionit të atëhershëm për Arsim Kulturë Rini dhe Sport. Pse? Sepse, ai amendament e bënte ligjin të paimplementueshëm në këtë pikë, e neve na interesonte më së shumti kjo pikë.

Çka do të thotë kjo? Ligji për tatimin në të ardhura të korporatave është ligj bazik. Është nga ato ligje që s'mund të ndërrohet, s'mund të ndryshohet në disa pika me ligje të fushave specifike. Çfarë thoshte ky ligj atëherë? Që lehtësirat financiare tatimore janë 10%, ndërkaq në fusha specifike mund të lejohen deri në 10%, që domethënë 11, 15, 19, 20, por jo 21. Dhe, ne e patëm bërë edhe +20%, që domethënë deri në 30%. Kjo ia bënte të pamundur Administratës Tatimore që të implementonte Ligjin për sponsorizim.

Tani, ne duhet të ndryshojmë këtë projektligj. Kjo është e domosdoshme. I kemi humbur dy vjet, është punë tjetër dhe unë besoj që duhet ta bëjmë sot. Nuk është kjo tashmë çështje metode. Meqë si shifra janë njëjta, unë mendoj që të ecim përpara, të përkrahim këtë amendament. Të votojmë që të mund të hapim rrugë që ta miratojmë ligjin. Faleminderit!



KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdixhiku e ka fjalën, në emër të komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Pas konsultimeve që i bëmë me anëtarët e komisionit dhe me shefat e grupeve parlamentare, disa prej tyre që kanë qenë sponsorizues. Ideja ka qenë që të vendoset njëfarë kontrolli më i mirë brenda Administratës Tatimore të Kosovës, në mënyrë që të parandalohet shpëlarja e parasë nëpërmes ligjit në fjalë. Gjithsesi dy amendamente s'mund të shkojnë bashkë njëra me tjetrën.

Në emër të komisionit propozoj që të tërhiqet amendamenti i komisionit dhe të mbahet amendamenti i deputetit Haxhiu, që në thelb po themi janë dy amendamente të njëjta sa i përket kontributit në sport, por e rregullojnë çështjen e burokracisë së kontributit të bizneseve tek sportistët dhe ekipet sportive. Pra, propozoj që të tërhiqet amendamenti i komisionit dhe të votohet vetëm amendamenti i deputetit Haxhiu.

KRYESUESI: Zoti Abdixhiku, është mirë që në emër të komisionit tani të kërkonti, për shkak edhe të procedurave, se cilin amendament komisioni kërkon ta zhvotojë dhe ta rivotojë amendamentin tjetër, sepse ne duhet ta votojmë tërheqjen e amendamentit...

Qy, jo! A po më kallon ti qysh, a? Lëre mos më kallëzo ti mua. Na s'mund me dy amendamentet në kundërshtim me njëra-tjetrën të shkojmë në votim. Jooo! Po, a u votua amendamenti i tyre. Po, more! A u votua amendamenti i juaj, Lumir. Jo a? Ani, në rregull, në rregull.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Atëherë, zonja dhe zotërinj deputetë,

U sqaruam pjesërisht. Në qoftë se ka dikush ankesa, mundësitë janë, por meqenëse edhe kryetari i Komisionit u pajtua që të kalojë amendamenti i pestë i propozuar nga zoti Haxhiu, unë e qes në propozim për t'u rivotuar amendamenti i 5-të i zotit Haxhiu dhe për të mos u votuar. Në qoftë se kalon ky, domethënë në mënyrë automatike bie amendamenti i komisionit, edhe pse ata e tërhoqën.

Atëherë, a ka kuorum për votim? Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Amendamentin e 5-të, propozim i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, në fakt tani me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tani!

E përsëris edhe një herë. Po thonë s'kanë punuar kartelat, por me siguri s'kanë dashur të votojnë, se kartelat janë në rregull.

Edhe një herë e përsëris votimin. A është dikush jashtë salle atje në pjesën e prapme? Në sallë janë 73 deputetë. Edhe një herë ju lus për votim. Votojmë tani!

Nuk ka votat e duhura. Më vjen keq!

Mendova se u arrit pajtueshmëri e të gjithëve, por prapë nuk është gjendja që ka... mbesim në gjendjen e mëparshme të ligjit.

#### **5. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi**

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Regjia dhe deputetët, përgatituni për votim. Votojmë tani!

Nuk kalon. Kemi 49 vota pro, 49 deputetë kanë votuar.

#### **4. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare**

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Nuk kalon. Kanë votuar vetëm 41 deputetë. Të tjerët nuk kanë votuar.

#### **6. Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në vitin 2017**

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Nuk kalon. Vetëm 37 deputetë kanë votuar.

#### **7. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017**

Komisioni funksional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Edhe ky nuk për këtë raport nuk ka kuorumin e duhur të votave.

## **8. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore**

Edhe ky besoj në të njëjtën gjendje është.

Procedojmë me votimin për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për trashëgimi Kulturore, në këtë përbërje: Zanita Halimi, Premtim Alaj, Arjeta Myftari, Arsim Mehmeti, Muharrem Qerimi, Bego Kululleri dhe Filjko Jovanoviq.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tani! Regjia!

Kanë votuar 39 deputetë. Nuk është kuorumi i duhur. Përsëritet në seancën e ardhshme.

## **9. Votimi për shkarkimin e një (1) anëtari të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare**

Procedojmë me votimin për shkarkimin anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare, Shqipërim Pula, sipas rekomandimit të Komisionit funksional.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 33 deputetë. Shtyhet për seancat e radhës.

## **11. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë**

Po futemi në votimin e propozim-rezolutës. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar gjithsej 28 deputetë. Shtyhet për mbledhjet e tjera.

## **10. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës**

Votojmë tani!

Po çfarë skandalesh Ministria e Jashtme, ku ka skandale?!

**12. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mos liberalizim të vizave,**

Votojmë tani! Regjia!

Pse po thoni ka dështuar koalicioni kur s'e votoni rezolutën?

Nuk kalon. E lëmë për seancën e radhës.

**13. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës**

Votojmë tash!

Mirë, mirë! Prapë s'ka.

Dyzet vota janë krejt s'kalon, 41 me një që s'ka aso.

Ju lus që ata që s'janë në sallë, të vijnë në sallë, sepse kemi mbetur pa kuorum!

Po vazhdojmë pra.

**14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike**

Pika 14, që është e shënuar këtu, Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Qeveria nuk e ka sjellë ministrin dhe nuk kemi çfarë votojmë, në qoftë se s'është ministri, as si propozues Qeveria.

Në qoftë se keni ndonjë mendim tjetër. Zoti Kryetar i Komisionit, a keni ndonjë mendim?

Zoti Nitaj e ka fjalën!

MUHARREM NITAJ: Zoti nënkryetar nuk e kam. Isha jashtë, nuk e di për cilin projektligj është fjala?

KRYESUESI: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike.

MUHARREM NITAJ: Po. Në fakt, nuk qenka Qeveria këtu. Në fakt, Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2019, e ka shqyrtuar Projektligjin. Në bazë të, d.m.th. plotëson kushtet e parapara nga neni 54 i Rregullores së Kuvendit dhe Komisioni me votë faktikisht unanime ka miratuar rekomandimin që seanca plenare ta votojë këtë projektligj. Unë nuk e di pse nuk janë, nuk është ministri i Bujqësisë si sponsorizuese e këtij projektligji dhe realisht nuk e di sesi do të duhej të pozicionoheshim. Ndoshta është mirë që seanca plenare ta votojë pavarësisht se nuk është sponsorizuesi këtu. Meqenëse është në lexim të parë.

KRYESUESI: Unë e kisha qitur në votim, edhe në diskutim, në qoftë se jeni dakord? Ata e kanë dërguar ligjin, ju e keni përgatitur për seancë, kështu që unë mendoj që bën edhe të votojmë, pse jo.

Po besoj që edhe kryetarët e grupeve parlamentare do të ishte mirë të deklarohen. Në emër të grupit parlamentar të LDK-së, z. Hoti?

AVDULLAH HOTI: Urdhëroni, zoti nënkryetar!

KRYESUESI: E kemi në shqyrtim të parë Projektligjin për pijet e forta alkoolike. Ministria s'është këtu.

AVDULLAH HOTI: Po ju po e vëreni si po shkon në Kuvend prej se e keni hapur këtë seancë. Nuk ka kuorum, as s'ka kuptim që të vazhdohet më tutje, kjo seancë.

KRYESUESI: Kuorum ka, po ju s'po votoni! Këtu është!

AVDULLAH HOTI: Në këtë gjendje e keni sjellë Kuvendin e Kosovës.

KRYESUESI: Këto janë dy sende. Kuorumi është në sallë, e ju s'po votoni.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë meqenëse nuk funksionon, po presim që në seancën e ardhshme të vjen edhe përfaqësuesi i Qeverisë, ta qesim në votim. Faleminderit!

**15. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP Partia Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh.a./NKEC**

Mua po më duket keni ju marrëveshje me ministrat, mos t'u votohen këto rezoluta që i kemi miratuar. Kështu që, faleminderit që po e ndihmoni edhe Qeverinë me këtë rast.

Memli, a je paraqitur për të diskutuar? A e shtyjmë?

Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit!

Ka kohë që e kemi sjellë këtë rezolutë dhe kisha kërkuar nga seanca që të hedhet në votim. Dje, edhe në Komision FunkSIONAL, i cili merret me temën, në pyetjet që ndërlihdeshin me ndërmarrjen nuk kishte ndonjë përgjigje.

Thjesht është një ndërmarrje e cila nuk do të ketë asnjë rol për tri vitet e ardhshme dhe shkakton telashe në zinxhirin energjetik në këtë vend. Kështu që, unë kërkoj votën nga Kuvendi për rezolutën në fjalë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë, unë e hedh në votim projekt-rezolutën. E lexoj edhe njëherë, nëse s'e keni parasysh se për çka bëhet fjalë. Është votimi i rekomandimeve nga interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, zotit Valdrin Lluka, sipas kërkesë së kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, zotit Dardan Sejdiu, i mbështetur nga 11 deputetë në lidhje me themelimin e ndërmarrje së re energjetike të Kosovës, sh.a./NKEC.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tani. Nuk kalon as kjo, sepse pavarësisht që ka kuorum prej 66 deputetësh në sallë, nuk votojnë të gjithë. Kanë votuar vetëm 38 deputetë.

Pikat e para përfunduan nga seanca më 30 janar 2019.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për pikat e kësaj seance kanë përfunduar në seancat e mëparshme. Sot, procedojmë vetëm me votimin e tyre.

### **1. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore**

2/3 s'i kemi. Atëherë e largojmë krejt që të mos e hedhim në votim. E kemi edhe një me 2/3, edhe unë po besoj që kemi mundur që të merremi vesh që së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare që këto marrëveshje t'i votojmë sot.

Megjithatë, kjo është çështje e deputetëve dhe e grupeve parlamentare.

I kemi pikat e papërfunduara nga seanca plenare e mbajtur më 28 shkurt 2019. Diskutimet për pikat e rendit të ditës; 1,2,3 dhe 5 kanë përfunduar në seancat e mëparshme. Sot, procedojmë me votimin e tyre.

### **1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete**

Këtë projektligj, në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 4 amendamente. Procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes, i paraqitur në raport nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Në seancën plenare të mbajtur më 15 prill 2019, deputeti Mërgim Lushtaku e ka riformuluar amendamentin e parë. Tani, fillojmë me votimin e amendamenteve.

Muharrem Nitaj e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zoti Nitaj!

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Nuk besoj që këto amendamente do të kalojnë. Ka qenë një version krejt tjetër i cili ka dalë nga grupi punues që është marrë me trajtimin e ligjit dhe nga komisioni.

Ndërkohë, që ka pësuar një ndryshim rrënjësorë në seancë plenare, me propozimin e zotit Lushtaku.

Unë besoj që ky projektligj duhet të kthehet edhe njëherë në komision. Duhet të trajtohet dhe t'i rikthehet seancës plenare për votim më vonë. Në mënyrën sesi është përpiluar dhe në mënyrën sesi është propozuar nga zoti Lushtaku, dhe në kohën kur nuk ka një dakordim të grupeve parlamentare, unë besoj që do të shpenzojmë energji kot. Do të votojmë kot, dhe nuk do të prodhojmë rezultat.

Ky projektligj duhet me patjetër të rikthehet edhe një herë në grupin punues dhe në Komisionin për Ekonomi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë jam i obliguar që ta hedh në votim. Në qoftë se nuk kalon amendamenti i parë, kuptohet që duhet ta heqim. Votojmë amendamentin e parë, votojmë tani!

Nuk kalon as ky amendament. Ka vetëm 33 vota. E shtyjmë miratimin e këtij projektligji për seancat tjera.

Mirë është që komisioni, në qoftë se folët në emër të komisionit, proceduralisht me ndjek, dhe të kërkohet nga Parlamenti që të rishikohet ligji. Do të ishte mirë që shumicën e këtyre t'i votojmë dhe t'i heqim prej rendit të ditës, meqë nuk po votohen dhe të vazhdohet me seancat e rregullta në qoftë se kemi çka votojmë tjetër dhe çka diskutojmë.

## **2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale**

Në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018, janë miratuar amendamentet e propozuara për këtë projektligj. Sot, procedojmë me votimin e tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani.

Kanë votuar 35 deputetë. S'është me rëndësi rezultati. Kuorumi nuk voton në tërësi dhe i shmangen kësaj.

## **3. Votimi në lexim të dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Duhet ta kemi kuorumin e dukur. Nuk e kemi kuorumin e duhur.

## **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë**

Edhe ky i do 2/3. Nuk i kemi në sallë 2/3.

## **5. Votimi i rundit të dytë për zgjedhjen e gjashtë (6) anëtarëve të Këshillit për Ndhmë Juridike Falas**

Në seancën plenare të mbajtur më 28 shkurt 2019, për rrethin e parë të votimit, anëtarët e Këshillit për Ndhmë Juridike Falas, është zgjedhur vetëm kandidatja Hidajete Vokshi, e propozuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Andaj, sot procedojmë me rundin e dytë të votimit me kandidatët që kanë fituar më shumë vota në rrethin e parë të votimit, si në vijim:

Prej kandidatëve të propozuar nga Ministria e Drejtësisë janë: Labinot Gashi dhe Fisnik Krasniqi.

Prej kandidatëve të propozuar nga Ministria e Financave janë: Lumnije Hetemi dhe Shyqyri Hyseni.



Prej kandidatëve të propozuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës janë: Admir Salihu dhe Muharrem Hoti.

Prej kandidatëve të propozuar nga Gjykata Supreme e Republikës janë: Rifat Haxha dhe Rasim Rasimi.

Prej kandidatëve të propozuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim janë: Drita Uglari dhe Mita Staletoviq.

Prej kandidatëve të propozuar nga organizatat joqeveritare janë: Fitore Shala dhe Nazife Jonuzi.

Në raundin e dytë të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas do të procedojë komisioni votues, i formuar në seancën plenare të mbajtur më 28 shkurt 2019, si në vijim: Driton Selmanaj, Hajdar Beqa, Salih Zyba, Rasim Selmanaj, Driton Çausi, Veton Berisha dhe Bahrim Shabani.

Ky është votim i fshehtë dhe e kisha lënë në fund. Ta lëmë në fund, t'i kryejmë këto pikat tjera dhe...Derisa të përgatiten me kutitë e me fletëvotimet, ne po i kalojmë pikat tjera.

Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 12 mars 2019.

### **1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara**

Diskutimet për këtë çështje kanë përfunduar në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 12 mars 2019.

Ftoj deputetin Driton Selmanaj që ta paraqesë propozim-rezolutën. A është Dritoni këtu? Jo! Atëherë, regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash!

Edhe kjo shtyhet për seancat e radhës për shkak të kuorumit që është në sallë, por nuk voton.

Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 13 mars 2019.

### **1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti**

Mendoj që kjo është tejkaluar, por meqë kanë mbetur po e qesim... Po, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Bashkë me partitë e tjera opozitare, ne jemi propozues të kësaj rezolute. Duke qenë se anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë emëruar sipas Kushtetutës dhe ligjit përkatës, në përputhje edhe me kërkesën tonë që ka qenë, ne e tërheqim këtë rezolutë.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë mendoj që ju e keni tërhequr rezolutën dhe e heqim nga rendi i ditës. Faleminderit që na e lehtësuat për një pikë të rendit të ditës.

Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2019.

**1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për situatën e krijuar në arsim pas vendimit të SBASHK-ut për të refuzuar kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës 3-javore**

Procedojmë me votimin, votojmë tash. Kuorumi i domosdoshëm është në sallë. Kanë votuar vetëm 23 deputetë. Shtyhet për seancat e radhës.

Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 11 prill 2019.

**1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me zbrazjen e vendit nga të rinjtë, si rreziku më i madh që i kanoset vendit që nga paslufta**

Ftoj deputetin Fidan Rekaliu që ta paraqesë propozim e rezolutës, në qoftë se dëshiron. Në qoftë se jo, procedojmë me votim. A dëshiron të flasësh?

FIDAN REKALIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ne e kemi diskutuar bashkërisht me përfaqësuesit e grupeve parlamentare rezolutën dhe e kemi përfaruar këtë rezolutë.

Unë kërkoj që të hedhet në votim.

KRYESUESI: Faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Një sukses, ke mbërrir deri në 50 vota. E shtymë për seancën e ardhshme. Disa s'po votojnë, por çfarë të bëjmë.

Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 prill 2019.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për pikat 2,3 dhe 4, kanë përfunduar në seancën e mëparshme. Procedojmë me votimin e tyre.

Atëherë, votojmë tani! E kemi gati që ta kryejmë, kështu që të mos marrim pauzë hiç. Votojmë tani! Regjia!

Kanë votuar 31 deputetë, të tjerët nuk duan të votojnë, edhe kjo shtyhet për seancat e radhës.

## **2. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributdhënës**

Zonja Haxhiu, a dëshironi ta merrni fjalën, zonja Haxhiu e ka fjalën, edhe Bekim Haxhiu pastaj.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Duke e ditur problemin që e kanë pensionistët kontributdhënës dhe mohimi i së drejtës elementare për të gëzuar pensionet me vendosjen e një kriteri që është shpikur prej 15 vjetësh, unë i lus kolegët deputetë që të votojnë rezolutën në fjalë, në mënyrë që ata të cilët edhe janë larguar prej punës në kohën e ish-regjimit, domethënë janë larguar dhunshëm nga puna dhe është edhe diskriminim pikërisht ata që janë larguar prej punës po marrin pensionet njëjtë sikur pensionistët e moshës, edhe pse kanë punuar.

Pra, unë i lus deputetët që sinqerisht nuk është interesi i subjekteve politike, por është interesi i të gjithëve, ngase pikërisht ata pensionistë, shumica prej neve jemi edhe ish-nxënësit e tyre, pra është në dorën tonë që të votojmë një rezolutë dhe të kërkojmë sa më parë ndryshimin e Udhëzimit administrativ 2015, duke kërkuar që për secilin vit që ata kanë punuar, të marrin kontributet varësisht prej viteve që kanë marrë, pra të hiqet viti 15 ose ajo që kërkohet me Udhëzim administrativ.

Pra, është një periudhë e shkurtër, udhëzimi administrativ mund të ndryshohet, mirëpo të mos hyjmë në procedura të tjera për ndryshimin e ligjeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu, urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Duke i dhënë mbështetje të plotë kësaj rezolute dhe nevojës që vërtet diskriminimi i deritanishëm që është bërë ndaj kategorive meritore, kontributdhënëse, të eliminohet.

Kërkoj që përveç kësaj, t'i shtohet edhe një pikë tjetër rezolutës dhe po e lexoj: “Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të arrijë marrëveshje për shpërndarjen e pensioneve me Postën e Kosovës”. Kjo do të mundësonte që pensionistët, të cilët nuk kanë mundësi të shkojnë në banka ose të lajmërohen në zyrat e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që një gjë e tillë të mundësohet përmes Postës së Kosovës dhe kjo do të ishte edhe më pak e kushtueshme për ta dhe më pak e kushtueshme për shtetin dhe do të mundësonte edhe zhvillimin e Postës së Kosovës.

Njëkohësisht, pra me këtë detyrim, nëpërmjet kësaj rezolute do të bënim një të mirë në tri drejtime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Valentina Bunjaku Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Përshëndetje për ju kolegë deputetë dhe ju deputete, Fillimisht unë pajtohem me kolegët e mi, realisht për kompensimin e mësimdhënësve të viteve '90-ta, mirëpo zonja Haxhiu e ka kryeministrin e vet dhe ministri është në Qeveri me ta, besoj që me një udhëzim administrativ, i cili kryeministri duhet ta obligojë ministrin t'ia sjellë udhëzimin administrativ dhe me një udhëzim administrativ rregullohet kjo çështje.

Besoj që mjaft kemi bë populizëm edhe marketing politik me mësimdhënësit e viteve të '90-ta. Unë e përgëzoj këtë Qeveri që e ka sjellë këtë projektligj për mësimdhënësit të viteve të '90-ta, por realisht duhet të jetë e mjaftueshme me këto marketingje mediatike, sepse me një udhëzim, të cilin duhet ta nënshkruajë ministri, zgjidhet kjo çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Nënkyetar, faleminderit!

Po sinqerisht unë e di shumë herë që ia huqin krejt deputetët, në këtë rast po kërkoj falje, por kolegja nuk është në rrjedha, po flasim për diçka tjetër, sepse Ligji i punëtorëve të viteve '90-ta ka kaluar dhe fatmirësisht që ka kaluar dhe buxheti është i ndarë për atë ligj. Është krejt një çështje tjetër, e nderuara kolege e komisionit, zonja Bunjaku, nuk po flasim për atë, se ai është ligj që ka kaluar, është ndarë fatmirësisht buxheti dhe unë normal që kërkoj me urgjencë që edhe udhëzimet administrative për atë ligj të nënshkruhen nga ministri sa më parë, sepse është krejt diçka tjetër.

Po flasim për një rezolutë të pensionistëve kontributdhënës, po e sqaroj për deputetët, kam bërë edhe një shkresë zyrtare për të gjitha grupet parlamentare në kohën kur është diskutuar në debat pra këtu dhe u kam kërkuar me shkrim të gjitha grupeve parlamentare nëse kanë diçka për t'i shtuar rezolutës, nuk kam marrë asnjë shkresë nga asnjë grup parlamentar, që i bie që rezoluta, e cila është propozuar, është pra ajo që edhe ju e lexuat dhe unë edhe një herë kërkoj, pra po flasim

për pensionistët kontributdhënës, jo për punëtorët e viteve të '90-ta, sepse ajo është çështje e kryer.

**KRYESUESI:** Zonja Bunjaku, kundër-replikë.

**VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI:** Realisht këtu u fol edhe për udhëzimin administrativ dhe, 'huq për huq, ia ka huq kolegja', sepse e ka pështjellë krejt. Nuk di a është duke folur për udhëzimin administrim, a është duke folur për kontributin e mësimdhënësve, a çka është duke folur.

Realisht e ka ministrin e vet në Qeveri, zgjidhni problemet përmes udhëzimeve administrative, të cilën e rregulloni me ligj.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e dëgjova edhe kolegen Haxhiu në lidhje me përgjigjen që i kemi marrë në lidhje me udhëzimin administrativ.

Edhe ne si grup parlamentar kemi punuar relativisht gjatë në këtë çështje dhe e kisha lutur edhe një herë zonjën Haxhiu që për një kohë ta tërheqë, sepse ka edhe pika ose nene të ligjit që duhet të ndryshohen, jo vetëm udhëzimi administrativ dhe ka edhe udhëzime të tjera administrative që duhet të ndryshohen, që të hiqen të gjitha dilemat për këtë çështje për një periudhë pesëmbëdhjetëvjeçare.

Unë po e them këtë për një arsye, sepse kemi bërë përpjekje të shohim edhe burimin prej nga ka ardhur ky kufizim në Ligjin për skema pensionale të financuara nga shteti.

Edhe i kemi nxjerrë të gjitha gazetata zyrtare, në të cilat janë thirrur hartuesit e këtij ligji në vitet 2014 dhe 2015, ne kemi gjetur edhe diskriminime të natyrave të tjera dhe këto diskriminime janë bartur pa ndonjë interpretim, pa ndonjë gjykim të drejtë në Ligjin për skemat pensionale, dhe nga Ligji për skema pensionale janë bartur edhe në udhëzimet administrative.

Ligji po ashtu ka edhe nene, të cilat ne duhet t'i shikojmë me shumë kujdes, sidomos nenin 36 të këtij ligji që po ashtu është diskriminues, edhe kemi edhe udhëzimin administrativ që ka të bëjë për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues, që po ashtu ndikohet drejtpërdrejt nga ligji.

Unë kisha lutur dhe kisha kërkuar nga propozuesi i rezolutës, nga zonja Haxhiu, që ta tërheqë këtë rezolutë që të përpunohet mirë, të shihen edhe pjesët e ligjit, të cilat janë diskriminuese, në

të vërtetë të shihet burimi sekondar prej nga vjen diskriminimi në udhëzimin administrativ dhe mandej nëse ka nevojë të shihet edhe burimi primar, burimi primar domethënë është Ligji për pensionet e ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, e në anën tjetër i Republikës Federative të Jugosllavisë, vitet '82-'83, t'i shqyrtojmë këto me kujdes dhe mandej të nxjerrim një rezolutë, në qoftë se ka nevojë dhe ta rregullojmë këtë çështje. Por, kjo çështje nuk ndryshohet vetëm me heqjen e këtij kufizimi në udhëzimin administrativ, të cilin po e përmendim, sepse edhe nëse hiqet kufizimi, udhëzimi administrativ do të jetë i kundërligjshëm, sepse në ligj mbetet ky kufizim. Prandaj, kisha kërkuar që kjo të përpunohet, ne kemi punuar gjatë, këto i kemi nxjerrë të gjitha burimet i kemi, edhe pjesët e ligjeve që duhet të ndryshohen dhe mandej udhëzimi administrativ në të vërtetë mund të ndryshohet me një veprim të njëanshëm të ministrit që e ka atë kompetencë ligjore, natyrisht kur bazohet në ligjin, në të cilin thirret ose bazohet udhëzimi administrativ.

Prandaj, e kisha lutur zonjën Haxhiu që ta tërheqë këtë, të ulen të gjitha grupet parlamentare, të analizojnë mirë edhe ligjin, ta shohin dhe mandej mund ta diskutojmë, mund ta nxjerrim, mund ta bëjmë si propozim, por përndryshe, nuk ka mund të ndryshohet vetëm udhëzimi administrativ, që në të vërtetë pjesërisht pajtohem me zonjën, me kolegen nga LDK-ja që mund të ndryshohet vetëm nga ministri. Po them nuk është për këtë çështje, por është për çështje të tjera, udhëzimi administrativ është vendim i ministrit, kurse ligji përmban këtë kufizim arbitrar. Edhe një herë, kërkesa është që të ulemi, ta diskutojmë mirë dhe t'i japim fund kësaj çështje në mënyrë të drejtë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Kurteshi! Për replikë është paraqitur zonja Teuta Haxhiu, i është përmendur emri.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Kur e thashë më herët që deputetët po ngatërrohen, në fakt deputetja, kërkoj falje prej deputetëve të tjerë, unë e kam edhe një shkresë që ua kam dërguar të gjitha grupeve parlamentare, ama të gjithave zyrtarisht, më datën 29 maj, që kam kërkuar, pra që të gjitha grupet parlamentare, ju lus që ta përcillni te deputetët e-mail-in dhe t'i lusni deputetët që nëse kanë rekomandime shtesë, t'i përcjellin në këtë e-mail deri më datën 18 prill.

Domethënë, në fakt, nuk ka ndodhur asnjë rekomandim i grupeve parlamentare, nuk m'u ka kthyer mua në shkresën zyrtare, pra për me t'ua rikujtuar edhe një herë kolegëve deputetë, përderisa me zotin Kurteshi ne kemi biseduar dhe jemi dakorduar atë ditë, unë sot po e shoh krejt një qëndrim tuj, unë deri dje kam menduar që është jurist, po dje e kam vërtetuar që nuk është jurist, sinqerisht, se vazhdimisht kam menduar, por e kam kuptuar që nuk është jurist, prandaj edhe një herë, derisa bashkërisht kemi punuar dhe jemi dakorduar, sidomos me zotin Kurteshi këtu, unë kërkoj që nëse duan të bëjnë zgjidhje, është pikërisht udhëzimi administrativ i nënshkruar më 2015 nga zoti Abrashi, i cili edhe në seancë gjatë debatit e ka konfirmuar që do ta

përkrahë këtë nismë, pra për t'ia kthyer, të mos them dinjitetin, por në fakt, një mohim që u është bërë padrejtësisht pensionistëve kontributdhënës.

Udhëzimi administrativ pra është ai, i cili ua ka pamundësuar për t'i marrë pensionet këtyre pensionistëve kontributdhënës. Andaj, edhe një herë, qoftë me shkresa në grupet parlamentare, për shkak se po i harrojnë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Kurteshi, kundër-replikë.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues! Unë si bujk, jo si jurist, po ia plotësoj dëshirën zonjës Haxhiu, unë po i them se nuk kemi marrë letër, po ne kemi diskutuar me zonjën Haxhiu, nuk kemi marrë letër, por ne kemi diskutuar, nuk e di, unë s'kam marrë, një.

Çështja tjetër, mund të sulmojë sa të dojë personalisht, po kjo s'ka të bëjë me pensionin tim ose të saj, po kjo ka të bëjë me pensionistët kontributpagues në Republikën e Kosovës. Prandaj, sulmet personale nuk kanë kuptim. Unë të luta ta tërheqësh, tash janë dy çështje që duhet sqaruar: udhëzimin administrativ s'ka nevojë ne të kërkojmë të ndryshohet, sepse e ndryshon ministri. Unë po ju them edhe një herë që është çështje e ligjit që duhet të ndryshohet dhe hajde ta bëjmë këtë punë, sepse s'mund të ndryshohet udhëzimi administrativ...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sejdiu e ka fjalën.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryesues!

Në fakt, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka autorizuar një komision që të trajtojë komplet çështjen e skemave pensionale dhe, si të thuhet problemeve që këto skema i kanë, por edhe të unifikojë shtatë ligjet që i kemi që trajtojnë skemat pensionale. Për informim, ky komision është tashmë pothuajse në përfundim të punës së tij dhe unë jam tepër i sigurt, të mos them kështu, i gatshëm bile të flas që ky koncept dokument dhe propozimi i komisionit do të vijë në Kuvend në fillim të sesionit vjeshtor dhe jam i interesuar që ta përkrahim këtë punë, në mënyrë që të vijmë me një propozim për një kod pensional, i cili unifikon skemat dhe ligjet në një kornizë të vetme, e kështu t'i trajtojmë të gjitha pabarazitë dhe padrejtësitë që janë bërë me skemat e ndryshme gjatë kohës, gjatë 20 vjetëve të fundit.

Pra, komisioni është duke e bërë punën e vet, secili deputet në të është duke kontribuar. Jemi takuar me të gjitha palët e interesuara, me të gjitha grupet, përfshirë edhe këtë kategori të pensionistëve, të cilët e kanë shprehur këtë shqetësim dhe e lus edhe deputeten e nderuar, Teuta

Haxhiu, që të presë punën e komisionit dhe të shohë që, në fakt, kjo është trajtuar edhe është trajtuar në mënyrë, të themi kështu, integruese, të gjitha problemet, të gjitha sfidat në një kod pensional dhe në një mënyrë të financimit, e cila i mundëson këtij vendi që një herë e përgjithmonë të ketë një ligj për sigurime pensionale, invalide, siç i ka hije. E, unë jam edhe një herë po e them, optimist që në fillim të sesionit vjeshtor këtë koncept do ta sjellim në Kuvend dhe kështu të trajtojmë çështjen e pensioneve në mënyrë të integruar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Unë isha duke e përmendur këtë që e tha Dardani, por me këtë vazhdë të punimeve të Kuvendit dhe kjo çka po reflektohet në Kuvend, unë mendoj që kjo çështje nuk zgjidhet, prandaj po kërkoj të hidhet në votim një rezolutë, e cila obligon ministrinë që ta ndryshojë udhëzimin diskriminues për këtë kategori.

KRYESUESI: Zoti Sejdiu, kundër-replikë!

DARDAN SEJDIU: Unë nuk dua të polemizoj mbi çështjen, unë dua të flas për rendin e gjërave, siç unë e shoh çështjen e pensioneve dhe mund të jem gabim, por duke i trajtuar një nga një temat në pensione për 20 vjetët e fundit, kemi përfunduar me 7 ligje e 23 skema pensionale.

Dhe, duke i zgjidhur problemet një nga një kështu, varësisht prej presioneve apo prej interesit, të themi kështu, në politikëbërjen që e kemi, s'po flas për interesa në konotacion negativ, kemi përfunduar në situata ku skemat e ndryshme diskriminojnë një kategori, ligjet nuk janë në përputhje me njëra-tjetrën dhe kështu në asnjë moment nuk po kemi një kod, një rrugë të qartë se si ta ndërtojmë një sistem pensional. Unë edhe një herë po kërkoj mirëkuptim për punën që po e bën komisioni dhe nëse keni durim deri në fillim të sesionit vjeshtor, unë ju siguroj që do të sjellim koncept...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të projektrezolutës. Votojmë tash!

Edhe kjo rezolutë e ka fatin e të tjerave. Shtyhet për "kalendra", meqenëse s'po dëshironi të votoni.



### **3. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, në lidhje me mosekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**

Zoti Topalli, a dëshironi të thoni diç lidhur me këtë? Fjalën e ka zoti Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Po. Ka kohë që keni marrë rezolutën për punëtorët e Fabrikës së Gypave. Debati për të cilin nuk është mbajtur, për arsye se unë atë ditë nuk kam qenë në seancë për arsye shëndetësore, prandaj dhe për këtë çështje nuk është zhvilluar fare debat. Megjithatë, rezoluta mbetet ajo që ishte.

Po mendoj që një pjesë e mirë juaja e njihni problemin e punonjësve të Fabrikës së Gypave, i cili në këtë Kuvend është shtruar në të tri legjislaturat e fundit dhe vazhdimisht ka pasur mbështetje, edhe të kryeministrave, në vazhdim për këtë çështje

Unë jua përkujtoj që Thaçi gjatë kohës kur ka qenë kryeministër është zotuar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për punëtorët e Fabrikës së Gypave do të ekzekutohet. Të njëjtin premtim e ka bërë edhe kryeministri i dikurshëm, Isa Mustafa, i cili para se të bëhej kryeministër u ka premtuar punonjësve të Fabrikës së Gypave se do ta ekzekutojë Vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe e njëjta gjë ka ndodhur edhe me kryeministrin Ramush Haradinaj. Pra, kemi tre kryeministra të fundit që janë zotuar publikisht se do ta bëjnë të mundur ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Të njëjtin premtim e ka bërë në fushatën parazgjedhore edhe zoti Albin Kurti, i cili është zotuar në emër të Lëvizjes Vetëvendosje se nëse do të bëhet kryeministër, atëherë do ta ekzekutojë këtë vendim. Pra, kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, i cili u jep të drejtë punonjësve të Fabrikës së Gypave, një vendim gjyqësor, i cili ka kaluar të gjitha shkallët e gjyqësisë dhe megjithatë nuk është ekzekutuar asnjëherë.

Ajo që kërkon rezoluta për të cilën ne sot do të votojmë, është që kryeministri dhe AKP-ja ta ekzekutojnë Vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Për ata që aktualisht nuk e dinë, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese këtë vendim e ka dërguar në Prokurori. Ajo që kërkohet nga ju, kolege e kolegë deputetë, është që të përcaktoheni me votën tuaj nëse jeni për zbatimin e ligjit, në qoftë se jeni, në qoftë se e njihni Gjykatën Kushtetuese si organin më të lartë vendimmarrës të vendit. Pra, ju do të votoni, respektivisht me votën tuaj do të përcaktoheni nëse pranoni vendimet e Gjykatës Kushtetuese apo nuk i pranoni. Edhe një votë kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese në këtë vend do të ishte shkelje e ligjit nga ligjvënësit.

Unë ju ftoj, që në emër të drejtësisë ta votoni këtë rezolutë dhe t'ua mundësoni punonjësve të Fabrikës së Gypave që t'u paguhet dëmi, i cili u është shkaktuar atyre.

Mendoj se asnjë kryeministër, po as ky Kuvend, nuk ka të drejtë në mënyrë arbitrare të përcaktojë se cilin vendim të Gjykatës e respekton dhe cilin nuk e respekton. Unë po ua lë tash ndërgjegjes suaj, që me votën tuaj të tregoni nëse e njihni vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nëse jeni për të drejtat e punëtorëve, për të cilat jeni angazhuar shumë herë në mbledhje të Kuvendit, e keni një rast konkret ku mund t'i mbështesni ata dhe që ta detyroni edhe AKP-në, edhe kryeministrin, që vendimet e organit më të lartë të gjykatave t'i respektojnë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi është paraqitur.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Ky është një vendim që i ka nja 20 vjet që sillet nëpër kasafortat e institucioneve të ndryshme. Unë e kuptoj fjalimin emocional të deputetit Topalli, por kërkesa pa alternativë: jeni kundër, ose jeni për, në të vërtetë nuk e ka vendin këtu. Ky është problemi.

Çështja është se institucionet kompetente në Republikën e Kosovës nuk e kanë zbatuar një vendim që është marrë tani e 15 vjet. Po të ishte çështja e ndonjë borxhi të vogël të pensionistëve të Kosovës për rrymën, për ndonjë kredi prej 400, 500, ose 1000 eurosh, shkon përmbaruesi ia ndalon shfrytëzimin e pensionit 100%, që është e ndaluar me ligj, edhe ia merr të hollat. Edhe këtu, ku është përmbaruesi?

Ne kemi vendime të plotfuqishme të gjykatës, qoftë të Gjykatës Kushtetuese, qoftë të të gjitha gjykatave të tjera, vendime të plotfuqishme. Këtu e ka vendin përmbaruesi. Ne si Kuvend i Republikës së Kosovës nuk jemi kundër. Unë nuk besoj që është çështje, tash po e them, edhe e Qeverisë, madje. Natyrisht, që qeveritë kanë gisht në këtë drejtim, edhe AKP-ja ka gisht në këtë drejtim, mirëpo Gjykata dhe përmbaruesit duhet ta identifikojnë vendin ku mbahen ato mjete që u takojnë atyre punëtorëve dhe të shkojnë e ta përmbarojnë vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës, që është vërtetuar tani e 15 vjet.

Për këtë ka marrë vendim Gjykata Kushtetuese, kanë bërë premtime të kota qeveritë e ndryshme, sepse qeveritë nuk ekzekutojnë vendimin. Vendimin e përmbaron përmbaruesi, ne i kemi këtu. Përmbaruesi vlen sikur për individët, sikur për institucionet dhe një rezolutë e këtij Kuvendi nuk e ndryshon detyrën e përmbaruesit, obligimin ligjor. Ne mund t'i bëjmë edhe nja 3 rezoluta të tjera, për këtë duhet të angazhohet përmbaruesi nga Gjykata ta përmbarojë Vendimin e Gjykatës që ua ka pranuar të drejtën e kompensimit punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj. Nuk janë vetëm këto institucione. Përveç grevës, mbi 600 ditë të atyre punëtorëve, të gjitha institucionet e tjera e kanë pranuar të drejtën e tyre, por s'mund ta zbatojnë atë të drejtë, sepse atë të drejtë sot, sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, e zbaton përmbaruesi.

Ju lutem, kushdo që mundet, në çfarëdo mënyre, duhet të kërkojë nga gjykata kompetente, e ajo është gjykata që ka marrë vendimin, është Gjykata e atëhershme Komunale, vendim të cilin nuk e ka ankimuar dhe nuk e ka rrëzuar asnjë shkallë më e lartë e ndonjë gjykate, vendim të cilin e ka konfirmuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duhet të shkojë gjykata kompetente ta thërrasë përmbauesin dhe përmbauesi ta përmbarojë obligimin e vet, sipas detyrës ligjore. Kaq!

Mirëpo, t'i detyrosh tash dhe të kërkojë në aspektin emocional nga deputetët “nëse votoni për, jeni për ligjshmëri në Kosovë dhe nëse votoni kundër, nuk jeni për ligjshmërinë...”, unë po e them se nuk është kjo dilemë. Nuk është kjo alternativë, por alternativa është që të kërkojë që në çfarëdo mënyre përmbauesi të kryejë punën e vet sipas detyrimit ligjor. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Topalli e ka kërkuar fjalën. Replikë!

**FATON TOPALLI:** Faleminderit për fjalën!

Faleminderit Sami për atë që the, por unë jam për frymën e bashkëpunimit dhe të kompromisit në Kuvend. Edhe për këtë çështje. Në fakt, bashkëpunimi dhe kompromisi janë dukur pak më pak nga ana e VV-së. Sidoqoftë, ajo që unë po kërkoj, është që si Kuvend, po edhe ju si grup parlamentar i VV-së ta shprehini vullnetin politik për zbatimin e ligjit. Tash natyrisht që në të gjitha rastet, e këtë e bëni ju çdo ditë, dhe e bëni edhe këtu në këtë Kuvend, duhet të shpreheni për ose kundër. Pra, kjo për ose kundër, në këtë rast jeni për mbështetjen e punonjësve të fabrikës së gypave, jeni për atë që të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese apo jo? Nuk e di çfarë do t'i kushtonte grupit parlamentar të VV-së në qoftë se do ta implementonte atë që z. Kurti ua premtoi punonjësve të Fabrikës së Gypave.

Sidoqoftë, këtu nuk është vetëm një grup parlamentar, ka edhe grupe të tjera parlamentare, prandaj unë ju ftoj ta votoni sepse ka tre kryeministra të cilët u kanë premtuar punonjësve të Fabrikës së Gypave që kanë këtë vendim për ta realizuar, nuk e kanë bërë deri tash, prandaj kërkojë një vullnet, një shprehje e vullnetit politik të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pra, po mendoj se nuk është shumë. Natyrisht që kur ka çështje të vështira, duhet përcaktuar për ose kundër. Kjo është në fund të fundit edhe detyra e neve si deputetë. Kështu që unë s'po kërkoj kurrëgjë më shumë nga se ju të përcaktoheni, thjesht ta thoni vullnetin politik, sa i përket zbatimit të ligjit në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kundër-replikë Sami a dëshiron? Jo?

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit z. kryesues!

Megjithatë, z. Topalli nuk është çështje e personalizimit edhe e tërheqjes në baza partiake, as nuk ishte çështja e bashkëpunimit, apo mosbashkëpunimit. Ju po e shtroni dilemën gabimisht! Ju po

kërkoni politika të përzihet në vendimet gjyqësore e të organeve kompetente, edhe tash po më thua mua, në qoftë se ti voton për t'ua dhënë atyre paratë, ti e njeh të drejtën, në qoftë se s'voton, s'e njeh të drejtën. Unë po them edhe një herë, është çështje, detyrim i organeve kompetente, i përmbauesit që e cakton Gjykata Themelore në Ferizaj, që e ka marrë vendimin të shkojë të përmbarojë vendimin. Edhe mos kërkoni nga deputetë të tjerë të deklarohen për një dilemë të gabueshme, për një dilemë inekzistente. Kjo është çështja.

Edhe në qoftë se e nxjerr një rezolutë Kuvendi i Republikës së Kosovës, nëse nuk merr vendim Gjykata Themelore në Ferizaj të detyrojë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka z. Miliam Zeka.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryesues!

E di që është ndërtuar prej 2008-tës e deri sot, e ndoshta edhe më herët sistem politik absurd në Kosovë, i pashpjegueshëm, i padefinuar dhe tepër i çuditshëm. Është çudi që në një vend mos të zbatohet një vendim i Gjykatave. Është çudi dhe pikërisht për shkak të këtyre çudirave, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian në Kosovë, përfaqësuesit e ambasadave të huaja na shohin shpeshherë, edhe Parlamentin, edhe zbatuesit e ligjit, edhe Qeverinë, edhe qeveritarët tanë si jashtëtokësorë.

Mirëpo, pse e mbështes iniciativën e deputetit Faton Topalli? Duke qenë ne të pafuqishëm si deputetë përballë një sistemi çoroditës që është ndërtuar në Republikën e Kosovës, ne të paktën e kemi një mundësi morale që t'u ndalim në ndihmë punëtorëve të Fabrikës së Gypave. T'u ndalim në ndihmë p.sh. atyre fshatarëve të shkretë në fshatin Bibaj që po duan t'ua shkatërrojnë jetën atje Komuna dhe Ministria jonë e Ambientit nëpërmjet ndërtimit të një hidrocentrali që rrezikon shpërnguljen masive të 1500 banorëve.

I nderuari kryesues i seancës,

Nuk ka përfaqësues politikë në Republikën e Kosovës, kryetarë partish, kryeministra, edhe Presidenti aktual, të cilët nuk kanë shkuar t'i gënjejnë punëtorët e Fabrikës së Gypave, të shkohet dhe të premtohet se ne do t'ua japim paratë, se ne do tua paguajmë paratë, në vend se liderët tanë politikë edhe ne ta shfrytëzojmë të vetmin kanal ndikimi për zbatimin e ligjit nga ana e gjykatës dhe institucionet tjera në Republikën e Kosovës.

Greva e punëtorëve të Fabrikës së Gypave që kanë qëndruar këtu me muaj të tërë, në sheshin "Nënë Tereza", para godinës së Qeverisë, do duhej ta shqetësonte çdo politikan.

Prandaj, pavarësisht se juridikisht mund të kemi dilema se a kemi ne të drejtë apo nuk kemi të drejtë, është e saktë që s’kemi të drejtë që të ndërhyjmë në sistemin e drejtësisë, por në anën tjetër mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë po na detyron neve që t’i kalojmë kompetencat tona.

Ne, po i tejkalojmë kompetencat si deputetë të Republikës së Kosovës, mirëpo gjykatat dhe ata që duhet t’i zbatojnë vendimet e gjykatave po e shkelin ligjin. Po bëjnë vepër penale.

Ne, të paktën nëpërmjet deklarimeve tona mund të ndodhë që bëjmë ndonjë shkarje, që nuk na ka hije që ne të përzihemi andej-këndej, por s’ke qare pa u përzier në një vend ku kurrkush në e respekton vendimin e gjykatës.

Prandaj, që ta mbyll fjalimin tim, të mos tallemi me këta punëtorë. Ata që u kanë premtuar që kanë për tua kthyer paratë, e që kanë menduar që i kanë paratë e baballarëve të tyre, e që kanë kuletën e vet. Ata që kanë blerë vota e i kanë mashtruar punëtorët që të votojnë për ta, unë nuk po dua t’i përmendi me emra, se m’i kanë thënë sindikatat.

I kam takuar sindikatat e punëtorëve të Fabrikës së Gypave, po besoj edhe Fatonit ia kanë thënë që kanë shkuar dhe u kanë thënë punëtorëve tekstualisht; votoni për mua se unë nuk jam sikur ai kryeministri.

Votoni për mua, se unë jam më burrë i mirë se ai tjetri. Ndërkaq, faktikisht këta kanë dalë krejt njësoj.

Unë, Faton ta mbështes rezolutën dhe e ke votën time pro.

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë të paraqitur. Meqenëse s’ka as kuorum, ne po e marrim një pauzë deri në orën 15:00, pastaj në qoftë se ka kuorum mirë, në qoftë se jo pushojmë. S’ka kuorum, çfarë të bëjmë.

Vazhdojmë në orën 15:00.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*